



AA. nr. 67/2011

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, Emine Kaçiku dhe Emine Mustafa, anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Raze Loshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Xhavit Ukës, kandidat i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa A. nr.115/2011, datë 02. 02.2011 në seancën e mbajtur më 05. 02. 2011, mori

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa.

A r s y e t i m i

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP), me seli në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit, të ushtruar për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të rinumërimit në Qendrat e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ose për shkak se gjatë futjes së të dhënave në Kompjuter, është dëmtuar për 213 vota në Vendvotimin nr. 2020 A/02R, në fshatin Piranë dhe në vendvotimin për 62 vota në Vendvotimin nr.2069 A/01 D në fshatin Dedaj.

PZAP-i, në përgjigje ndaj ankesës, ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (2008/03-L073) (LZP), i ndryshuar me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.03/L-073, juridiksionin e Gjykatës Supreme në çështjet e zgjedhjeve, e kufizon vetëm përkitazi me ankesat kundër vendimeve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa nëse ky Panel subjekteve politike, iu shqipton dënime me mbi 5000€ ose kur me vendimet e Panelit cenohet ndonjë e drejtë themelore.

Gjykata Supreme, pasi që i vlerësoi thëniet në ankesë dhe të gjitha shkakësit e lëndës në këtë çështje, ka gjetur se ankesa nuk është e bazuar.



Me dispozitën e nenit 3.6 c . të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me të cilat , në përputhje me nenin 1 të këtyre Rregullave, supozohet që janë të njoftuar me to të gjithë personat dhe entitetet që marrin pjesë në procesin zgjedhor , ankuesi në ankesë duhet të jap informacion të hollësishëm përkitazi me çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë. Dëshmitë të cilat i ka ofruara ankuesi janë rezultatet e fituara pas rinumërimit të votave në vendvotimet për të cilat ai pretendon se janë bërë parregullsitë. . Dëshmitë të cilat i ofron ankuesi nuk janë dëshmi me të cilat vihet në dyshim rregullsia e rinumërimit. Me këto rinumërime, siç drejt konstaton PZAP në vendimin e ankimuar, nga KQZ janë korrigjuar parregullsitë e pretendura

Nga sa u tha më sipër, me zbatimin enenit 42 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
A.A. nr.67/2011/ 04.02. 2011

Procesmbajtësja ,
Raze Loshaj

Kryetarja e kolegjit,
Vjosa Nimani-Zylfiu



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

*SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
*ТАЧНОСТ ОТПРАВКА ПОТВЕРДЖУЈЕ

Punëtori i autorizuar
Qytetarë radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës AA-67/11
 Oznaka spisa:

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

P. Z. A. P - P. M. S. H.

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqiu, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domacin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno clan njenog domacinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
 dana _____ u _____ cas.
 Shkaku i refuzimit të marrjes _____
 Razlog odbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljava

Emri i shkresës që dorëzohet:
 Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIVIZIMI TI 01
05-02-2011

Numri i shtojcave: _____
 broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
 më (me fjalë)
 Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
 (i slovima)

P. M. S. H. 05-02-2011
 (Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
 e ka marrë aktin në vend të tij
 Potpis primioaca ili lica koje je
 pismeno primilo u zamenu) 013
17 00

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljava

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtafi)

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.